

BURSA SHQIPTARE E ENERGJISË ELEKTRIKE - ALPEX SHA

VENDIM TEKNIK Nr. 7-C

Për “Vendosja e masave për Anëtarët e Klerimit”

Duke pasur parasysh dispozitat e;

- I. Seksioneve F.6.1, F.6.2, F.6.3 të Kapitullit F të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes

ALPEX SHA Miratoi:

1. Procedurën e vendosjes së masave për Anëtarët e Klerimit.
2. Vendimi Teknik Nr.7-C i paraqitet për njoftim Entit Rregullator të Energjisë – ERE / Zyrës së Rregullatorit për Energji ZRrE.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ADMINISTRATORI I ALPEX SHA

Sokol Dishnica

VENDIM TEKNIK Nr. 7-C

NENI 1

1. QËLLIMI, FUSHËVEPRIMI DHE PËRKUFIZIMET

1.1 Qëllimi i Fushëveprimit

- (a) Ky Vendim Teknik përcakton masat e marra sipas shembujve të përshkruar në F.6.2 të kapitullit F të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes.
- (b) Ky Vendim Teknik ka të bëjë me masat shtesë që përfshihen në seksionet F.1.1, F.2.1, F.2.2, F.2.3 të Kapitullit F, seksionet G.5.3, G.5.4 të Kapitullit G të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes dhe në lidhje me rastet e Mospërmbushjes së Detyrimeve të Anëtarëve të Klerimit dhe veprimet përkatëse të ALPEX.

1.2 Përkufizimet

- (a) Kushtet dhe përkufizimet e përdorura në këtë Vendim Teknik do të kenë të njëjtin kuptim si në Përkufizimet Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike dhe në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes, si dhe në vendimet e tjera të miratuara në zbatim të tij.
- (b) Në çdo rast, dispozitat e këtij Vendimi Teknik interpretohen në përputhje me rregullat dhe parimet e parashikuara në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes.

NENI 2

2. RASTET E PËRCAKTIMIT TË MASAVE

- (a) Për çdo rast të përfshirë në seksionin F.6.2 të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes, janë përcaktuar masat e mëposhtme.

Rastet	Masa fillestare	Masat në rast të përsëritjes ose të mos zgjidhjes së problemit brenda një kohe të arsyeshme ¹
1. Shkelja nga një Anëtar i Klerimit të dispozitave të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike -		

Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes, në veçanti:		
a) Një Anëtar i Klerimit nuk i plotëson fare ose nuk i plotëson siç duhet kushtet e nevojshme për anëtarësim si Anëtar i Klerimit, si për shembull me anë të treguesve:		
(i) Mungesa e pamjaftueshmërisë së kërkuar organizative dhe operacionale të Anëtarit të Klerimit	Vërejtje me shkrim	Gjopa është e barabartë me 10% të tarifave të Klerimit të llogaritura gjatë muajit të mëparshëm dhe brenda kushteve të përcaktuara në paragrafin F.6.1.1 (d) të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes. Nëse problemi nuk është zgjidhur brenda një kohe të arsyeshme, vendoset një kufizim në lidhje me pjesëmarrjen e Anëtarit të Klerimit. Nëse mos-zgjidhja zgjatet, fillimisht vendoset një pezullim i kapacitetit të Anëtarit të Klerimit dhe Anëtari i Klerimit fshihet përfundimisht.
(ii) Pakësimi i fondeve të veta të Anëtarit të Klerimit nën minimumin e kërkuar për marrjen e kapacitetit të lartpërmendur.	Vërejtje me shkrim	Nëse problemi nuk është zgjidhur brenda një kohe të arsyeshme, vendoset një kufizim lidhur me pjesëmarrjen e Anëtarit të Klerimit. Nëse mos-zgjidhja zgjatet, fillimisht vendoset një pezullim i kapacitetit të Anëtarit të Klerimit dhe Anëtari i Klerimit fshihet përfundimisht.
(iii) Dështimi i punonjësit të	Vërejtje me shkrim	Ndalimi i pjesëmarrjes së Agjentit Klerues të

<p>Anëtarit të Klerimit i cili kryen detyrat e Agjentit Klerues të Certifikuar për të përmbushur kriteret e pranimit</p>		<p>Certifikuar të Anëtarit të Klerimit në Klerim. Nëse problemi nuk është zgjidhur brenda një kohe të arsyeshme, vendoset një kufizim në lidhje me pjesëmarrjen e Anëtarit të Klerimit. Nëse moszgjidhja zgjatet, fillimisht vendoset një pezullim i kapacitetit të Anëtarit të Klerimit dhe Anëtari i Klerimit fshihet përfundimisht.</p>
<p>(iv) Mospërmbushja e Detyrimeve ose vonesa e pagimit në kohë të tarifave të anëtarësimit dhe tarifave të tjera dhe të detyrimeve në përgjithësi të Anëtarit të Klerimit ndaj ALPEX-it</p>	<p>Vërejtje me shkrim</p>	<p>Gjoha është e barabartë me 10% të pagesës me vonesë dhe brenda kushteve të përcaktuara në paragrafin F.6.1.1 (d) të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes. Nëse problemi nuk është zgjidhur brenda një kohe të arsyeshme, vendoset një kufizim në lidhje me pjesëmarrjen e Anëtarit të Klerimit. Nëse moszgjidhja zgjatet, Anëtari i Klerimit fshihet përfundimisht.</p>
<p>(v) Dështimi për të përmbushur kërkesat që kanë të bëjnë me Klerimin ose Shlyerjen e Transaksioneve, sipas rastit</p>	<p>Vërejtje me shkrim</p>	<p>Nëse problemi nuk është zgjidhur brenda një kohe të arsyeshme, vendoset një kufizim në lidhje me pjesëmarrjen e Anëtarit të Klerimit. Nëse moszgjidhja zgjatet, Anëtari i Klerimit fshihet përfundimisht.</p>
<p>b) Papajtueshmëria e një Anëtari Klerimi me udhëzimet teknike të ALPEX-it ose me specifikimet teknike të përcaktuara nga ALPEX-i për përdorimin dhe</p>	<p>Vërejtje me shkrim</p>	<p>Gjoha është e barabartë me 10% të tarifave të Klerimit të llogaritura gjatë muajit të mëparshëm dhe brenda kushteve të përcaktuara në paragrafin F.6.1.1 (d)</p>

<p>funksionimin e sistemeve të shfrytëzuara nga Anëtari i Klerimit për të marrë pjesë në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes.</p>		<p>të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes. Nëse problemi nuk është zgjidhur brenda një kohe të arsyeshme, vendoset një kufizim në lidhje me pjesëmarrjen e Anëtarit të Klerimit. Nëse mos-zgjidhja zgjatet, fillimisht vendoset një pezullim i kapacitetit të Anëtarit të Klerimit dhe Anëtari i Klerimit fshihet përfundimisht.</p>
<p>c) Përdorimi ose keqpërdorimi i paligjshëm ose i paautorizuar i sistemeve të përdorura nga një Anëtar Klerimi për pjesëmarrjen e tij në Klerim ose Shlyerjen e Transaksioneve.</p>	<p>Vërejtje me shkrim</p>	<p>Gjoha është e barabartë me 10% të tarifave të Klerimit, të llogaritura gjatë muajit të mëparshëm dhe brenda kushteve të përcaktuara në paragrafin F.6.1.1 (d) të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes. Nëse problemi nuk është zgjidhur brenda një kohe të arsyeshme, vendoset një kufizim në lidhje me pjesëmarrjen e Anëtarit të Klerimit. Nëse mos-zgjidhja zgjatet, fillimisht vendoset një pezullim i kapacitetit të Anëtarit të Klerimit dhe Anëtari i Klerimit fshihet përfundimisht.</p>
<p>d) Papajtueshmëria e një Anëtarit Klerimi me kërkesat e përcaktuara kohë pas kohe nga ALPEX-i në lidhje me pjesëmarrjen e tij në Klerim ose Shlyerje, si për shembull:</p>		

<p>(i) Mos sigurimi i Garancisë së kërkuar për ALPEX-in ose mos depozitimi i kontributeve të nevojshme në Fondin e Mospërmbushjes së Detyrimeve.</p>	<p>Vërejtje me shkrim</p>	<p>Nëse problemi nuk është zgjidhur brenda një kohe të arsyeshme, vendoset një kufizim lidhur me pjesëmarrjen e Anëtarit të Klerimit. Nëse mos-zgjidhja zgjatet, Anëtari i Klerimit fshihet përfundimisht</p>
<p>(ii) Monitorim i pamjaftueshëm i risqeve që rrjedhin nga pozicionet e Llogarive të Klerimit të mbajtura nga Anëtari i Klerimit.</p>	<p>Vërejtje me shkrim</p>	<p>Nëse problemi nuk është zgjidhur brenda një kohe të arsyeshme, vendoset një kufizim në lidhje me pjesëmarrjen e Anëtarit të Klerimit. Nëse mos-zgjidhja zgjatet, fillimisht vendoset një pezullim i kapacitetit të Anëtarit të Klerimit dhe përfundimisht Anëtari i Klerimit fshihet.</p>
<p>(iii) Dështimi i Anëtarit të Klerimit për të përmbushur detyrimet e tij ose për të vepruar sipas udhëzimeve të ALPEX-it në lidhje me menaxhimin e Mospërmbushjes së Detyrimeve në Llogaritë e Klerimit që mban ose përmbushjen me vonesë të detyrimeve të tij.</p>	<p>Vërejtje me shkrim</p>	<p>Nëse problemi nuk është zgjidhur brenda një kohe të arsyeshme, vendoset një kufizim në lidhje me pjesëmarrjen e Anëtarit të Klerimit. Nëse mos-zgjidhja zgjatet, Anëtari i Klerimit fshihet përfundimisht.</p>
<p>2. Dorëzimi nga një Anëtar Klerimi informacione të rreme ose false në ALPEX, si në rastet e mëposhtme:</p>		
<p>a) Me dorëzimin e aplikimit për fitimin e kapacitetit të Anëtarit të Klerimit.</p>	<p>Vërejtje me shkrim</p>	<p>Nëse paraqitet një informacioni i pa vërtetë ose mashtrues, dhe është e qartë se nuk është për shkak të neglizhencës së Anëtarit të Klerimit ose problemi</p>

		nuk është zgjidhur brenda një kohe të arsyeshme, vendoset një kufizim në lidhje me pjesëmarrjen e Anëtarit të Klerimit. Nëse mos-zgjidhja zgjatet, Anëtari i Klerimit fshihet përfundimisht.
b) Kur hap ose përdor ndonjë nga Llogaritë e Klerimit të Anëtarit të Bursës në lidhje me pjesëmarrjen e tij në Klerimin ose Shlyerjen e Transaksioneve.	Vërejtje me shkrim	Nëse paraqitet një informacioni i pa vërtetë ose mashtrues, dhe është e qartë se nuk është për shkak të neglizhencës së Anëtarit të Klerimit ose problemi nuk është zgjidhur brenda një kohe të arsyeshme, vendoset një kufizim në lidhje me pjesëmarrjen e Anëtarit të Klerimit. Nëse mos-zgjidhja zgjatet, Anëtari i Klerimit fshihet përfundimisht.
c) Me dorëzimin e të dhënave, dokumenteve mbështetëse ose informacioneve të kërkuara Anëtarit të Klerimit nga ALPEX-i herë pas here.	Vërejtje me shkrim	Nëse paraqitet një informacioni i pa vërtetë ose mashtrues, dhe është e qartë se nuk është për shkak të neglizhencës së Anëtarit ose problemi nuk është zgjidhur brenda një kohe të arsyeshme, vendoset një kufizim në lidhje me pjesëmarrjen e Anëtarit të Klerimit. Nëse mos-zgjidhja zgjatet, Anëtari i Klerimit fshihet përfundimisht.
3. Dështimi i një Anëtari Klerimi për të vepruar në përputhje me njoftimet, vendimet ose udhëzimet e ALPEX-it.	Vërejtje me shkrim	Nëse problemi nuk është zgjidhur brenda një kohe të arsyeshme, vendoset një kufizim në lidhje me pjesëmarrjen e Anëtarit të Klerimit. Nëse mos-zgjidhja zgjatet, fillimisht vendoset një pezullim i kapacitetit të

		Anëtarit të Klerimit dhe Anëtari i Klerimit fshihet përfundimisht.
<p>4. Mospërbushja ose përbushja e jo e duhur e detyrimeve të një Anëtari Klerimi që rrjedhin nga një apo të gjitha kontratat e nënshkruara me ALPEX-in, duke përfshirë, por pa u kufizuar në kontratat teknike dhe kontratat e përgjithshme të nënshkruara nga Anëtari i Klerimit me ALPEX-in me qëllim lidhjen me EMCS-në, si dhe çdo detyrim tjetër që rrjedh nga angazhimet e ndërmarra nga Anëtari i Klerimit ndaj ALPEX-it.</p>	Vërejtje me shkrim	<p>Gjoha është e barabartë me 10% të tarifave të Klerimit të llogaritura gjatë muajit të mëparshëm dhe brenda kushteve të përcaktuara në paragrafin F.6.1.1 (d) të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes. Nëse problemi nuk është zgjidhur brenda një kohe të arsyeshme, vendoset një kufizim në lidhje me pjesëmarrjen e Anëtarit të Klerimit. Nëse mos-zgjidhja zgjatet, fillimisht vendoset një pezullim i kapacitetit të Anëtarit të Klerimit dhe Anëtari i Klerimit fshihet përfundimisht.</p>
<p>5. Veprimet ose mosveprimet e një Anëtari Klerimi që dëmtojnë reputacionin dhe pozicionin e ALPEX-it ose diskreditojnë shërbimet e ofruara dhe aktivitetet e ushtruara nga ALPEX-i.</p>	Vërejtje me shkrim	<p>Gjoha është e barabartë me 10% të tarifave të Klerimit të llogaritura gjatë muajit të mëparshëm dhe brenda kushteve të përcaktuara në paragrafin F.6.1.1 (d) të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes. Nëse problemi nuk është zgjidhur brenda një kohe të arsyeshme, vendoset një kufizim në lidhje me pjesëmarrjen e Anëtarit të Klerimit. Nëse mos-zgjidhja zgjatet, fillimisht vendoset një pezullim i kapacitetit të Anëtarit të Klerimit dhe përfundimisht Anëtari i</p>

<p>6. Ndodhja e ngjarjeve që ndikojnë në funksionimin e një Anëtari Klerimi, të tilla si shpërbërja e ndërmarrjes ose shoqërisë së Anëtarit të Klerimit, nisja e procedurave të Paaftësisë paguese, duke përfshirë falimentimin, mbylljen e detyruar ose rehabilitimin e ndërmarrjes së Anëtarit të Klerimit, si dhe revokimin e licencës së Anëtarit të Klerimit për të operuar ose për të ofruar shërbime.</p>	<p>vendosjen e kufizimit në lidhje me pjesëmarrjen e Anëtarit të Klerimit ose pezullimin e kapacitetit të Anëtarit të Klerimit</p>	<p>Klerimit fshihet. Fshirja e Anëtarit të Klerimit</p>
<p>7. Vendosja e sanksioneve ndaj një Anëtari Klerimi nga Autoritetet Kompetente, të cilat nuk janë të lidhura drejtpërdrejt me operacionet e Klerimit.</p>	<p>Vërejtje me shkrim</p>	<p>Nëse problemi nuk është zgjidhur brenda një kohe të arsyeshme, vendoset një kufizim në lidhje me pjesëmarrjen e Anëtarit të Klerimit. Nëse mos-zgjidhja zgjatet, fillimisht vendoset një pezullim i kapacitetit të Anëtarit të Klerimit dhe Anëtari i Klerimit fshihet përfundimisht.</p>
<p>8. Marrjen nga ALPEX-i të informacionit nga Autoritetet Kompetente, duke e njoftuar atë se janë vendosur masa kundër një Anëtari Klerimi në mënyrë që të mbrojnë tregun.</p>	<p>Vendosja e masave të përcaktuara nga Autoritetet Kompetente (p.sh. vendosja e kufizimeve në lidhje me pjesëmarrjen e Anëtarit të Klerimit në Klerim)</p>	<p>Nëse problemi nuk është zgjidhur brenda një kohe të arsyeshme, vendoset një kufizim në lidhje me pjesëmarrjen e Anëtarit të Klerimit. Nëse mos-zgjidhja zgjatet, Anëtari i Klerimit fshihet përfundimisht.</p>

9. Sjellje e gabuar e rëndë nga një Anëtar Klerimi në lidhje me pajtueshmërinë e tij me dispozitat ligjore.	Vërejtje me shkrim	Nëse problemi nuk është zgjidhur brenda një kohe të arsyeshme vendoset një kufizim në lidhje me pjesëmarrjen e Anëtarit të Klerimit. Nëse mos-zgjidhja zgjatet, Anëtari i Klerimit fshihet përfundimisht.
--	--------------------	---

¹ brenda një kohe të arsyeshme varet nne çdo rast dhe i njoftohet Anëtarit të Klerimit gjatë vënies së masës fillestare

Procedura e vendosjes së masave të mësipërme përshkruhet në paragrafët F.6.3 deri në F.6.6 të Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes. Procedura e shqyrtimit të vendimeve rreth vendosjes të masave si dhe ekzekutimit dhe heqjes së tyre, të përshkuara në paragrafët F.6.4 & F.6.5 të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes.

NENI 3

3. HYRJA NË FUQI

Ky Vendim Teknik hyn në fuqi që nga data 07/09/2023.

Ky Vendim Teknik do të publikohet në faqen zyrtare të internetit www.alpex.al